

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Mosburger GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga Austria, me seli në Rugën Ketzergasse 112, 1230 Vjenë, Austri, të dorëzuar përmes avokatit Martin Ivanov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 10.06.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Mosburger GmbH, me seli në Rugën Ketzergasse 112, 1230 Vjenë, Austri, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi Wellpappenfabrik Gesellschaft mit beschränkter Haftung, me seli në Leininger Strasse 76, 67269 Grünstadt, Gjermani dhe Gaster Wellpappe GmbH, me seli në Kurpfalzring 109-113, 69123 Heidelberg, Gjermani, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 30.04.2026 dhe plotësuar më datë 12.05.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e Mosburger GmbH, me seli në Rugën Ketzergasse 112, 1230 Vjenë, Austri, me të cilin Mosburger GmbH do të fitojë kontrollin e vetëm mbi Wellpappenfabrik Gesellschaft mit beschränkter Haftung, me seli në Leininger Strasse 76, 67269 Grünstadt, Gjermani dhe Gaster Wellpappe GmbH, me seli në Kurpfalzring 109-113, 69123 Heidelberg, Gjermani.

Komisioni filloi me shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim, plotësimit dhe shtojcave të tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Mosburger GmbH e ka veprimtari kryesore prodhimin dhe shitjen e kartonit të valëzuar dhe produkteve nga ambalazhi i valëzuar. Mosburger GmbH është pjesë e Grupit Prinzhorn (Prinzhorn Group), një grup shoqëri i kontrolluar përfundimisht nga anëtarët e familjes Prinzhorn. Grupi Prinzhorn nuk ka prani fizike në Maqedoninë e Veriut, por divizioni i tij për karton ambalazhi (containerboard) dhe divizioni i tij për paketim shesin produkte në Maqedoninë e Veriut në një vëllim të caktuar. Grupi Prinzhorn është aktiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shitjes së pllakave dhe kutive të valëzuara (ambalazhit të valëzuar). Grupi Prinzhorn nuk ka subjekte të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Wellpappenfabrik Gesellschaft mit beschränkter Haftung e ka veprimtari kryesore menaxhimin me kapacitetin prodhues për karton të valëzuar dhe produkte nga ambalazhi i valëzuar.

Gaster Wellpappe GmbH e ka veprimtari kryesore prodhimin e kartonit të valëzuar (përfshirë rrotullat nga kartoni i valëzuar dhe kartonin e rëndë të valëzuar) dhe zhvillimin e zgjidhjeve të paketimit me cilësi të lartë, të përshtatura, si dhe në një masë më të vogël është aktive edhe në fushën e logjistikës dhe magazinimit.

Wellpappenfabrik Gesellschaft mit beschränkter Haftung dhe Gaster Wellpappe GmbH nuk janë të pranishme dhe nuk kanë asnjë aktivitet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ